



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura III**

Komisioni për Integritime Evropiane  
Mbledhja nr. 16  
Prishtinë, më 23. 09. 2008, ora 11:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

**PROCESVERBAL**  
**i mbledhjes së Komisionit për Integritime Evropiane**

Në mbledhje morën pjesë: Zylfije Hundozi, Džezair Murati, Hydajet Hyseni, Edita Tahiri, Fatmir Rexhepi, Njomza Emimi, Nait Hasani, Naser Rugova dhe Branislav Grbić

Pjesëmarrës të tjerë: Michele Dinelli - UNDP, Maria Berisha - OSBE, Jules Caron - OSBE, Fitore Zeneli - KDI, Agron Demi - GAP, Avni Zuka - NDI, Jan Meyer-Universiteti i Bremenit dhe Federike Wünschmann.

I ftuar: zv.kryeministri, Hajredin Kuçi.

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Ahtere Loxha dhe Adelina Demolli.

Mbledhjen e kryesoi Zylfije Hundozi - kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje është propozuar ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës,**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar,**
- 3. Raportim i zv/kryeministrit, Hajredin Kuçi, lidhur me progresin e zbatimit të Planit për integritime evropiane,**
- 4. Të ndryshme.**

*Kryesuesja konstatoi se janë plotësuar kushtet dhe e hapi mbledhjen për shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

## 1. Miratimi i rendit të ditës

*Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

**Hydajet Hyseni** - Kërkoj të harmonizohet orari i mbajtjes së mbledhjeve të komisioneve.

## 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

*Kryesuesja konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së kaluar pa vërejtje.*

## 3. Raportim i zv/kryeministrit, Hajredin Kuçi, lidhur me progresin e zbatimit të Planit për integritime evropiane

**Kryesuesja** - E falënderoi zv/kryeministrin për gatishmërinë që të raportojë në Komision lidhur me progresin e arritur në zbatimin e Planit për integritime evropiane. Ajo shtoi se Qeveria e ka miratuar Planin për integritime evropiane me disa orientime të përgjithshme strategjike dhe me afatizime të këtyre orientimeve. Si plan afatshkurtër është paraparë reformimi i administratës. Ajo pyeti se deri ku është arritur me përmbushjen e këtyre orientimeve dhe a është bërë përmirësim sa i përket vërejtjeve që kanë ardhur nga Komisioni Evropian.

**Hajredin Kuçi** - Tha se Bashkimi Evropian angazhohet në Kosovë nëpërmjet procesit të stabilizim asociimit. Me qëllim që Kosova të mos mbetet jashtë, krahasuar me vendet e tjera të Ballkanit kundrejt Bashkimit Evropian, BE-ja e ka themeluar mekanizmin përcjellës të stabilizim asociimit. Ai shtoi se në vitin 2006 BE e lansoi Partneritetin Evropian që e hartoi listën e rekomandimeve të BE-së për Qeverinë e Kosovës. Qeveria iu përgjigj Partneritetit Evropian me Planin e veprimit të Partneritetit Evropian që i merr përsipër obligimet që Kosova duhet t'i përmbushë. Këto vlerësime paraqiten në raportin e progresit që Komisioni Evropian e përgatit çdo vit në nëntor. Ai shtoi se Kosova është vendi i vetëm në Ballkan që nuk e ka nënshkruar Marrëveshjen e stabilizim asociimit që do të thotë nëse për ne qëllim është integrimi në Bashkimin Evropian, prioritet afatshkurtër dhe afatmesëm gjithsesi duhet të jetë nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje. Si pika pozitive, tha, janë vullneti politik për ta bërë procesin e integritimeve evropiane prioritet të Qeverisë, themelimi i strukturave që do ta bartin këtë proces përpara dhe vendosja e personave kompetentë në pozita që kanë të bëjnë me proceset evropiane. Dobësi në këtë proces janë shtrëngimet buxhetore të Kosovës. Si mundësi në aspektin juridik, për arsye se nga fillimi është punuar në infrastrukturën ligjore të Kosovës, ligjet janë në përputhje me **acquis communautaire**, kështu që në kohën e aderimit në BE nuk do të shpenzohet shumë kohë për harmonizimin e legjislacionit. Mundësi tjetër është prania e formacioneve të ndryshme të BE-së, këshillat dhe asistenca e tyre teknike dhe financiare. Ndërsa si rreziqe i përmendi, mosnjohjen e Pavarësisë së Kosovës nga të gjitha shtetet anëtare të BE-së, si dhe kapaciteti i BE-së për t'u zgjeruar. Shtoi se në nëntor do të rishikohet Plani dhe me këtë rast i ftoi anëtarët e Komisionit të marrin pjesë në mënyrë që të mos bëhen gabime që i kanë bërë shtetet e rajonit.

**Kryesuesja** - Tha se në Planin e integrimi evropiane është paraparë të caktohet një koordinator i posaçëm për IPA-në. A keni caktuar koordinator? Lidhur me përkthimin e **aquis communitaire**, pyeti a është nënshkruar ndonjë memorandum me Shqipërinë, sepse në takimin që e kanë pasur me ministren, Majlinda Bregu, u është thënë se po e presin nismën e palës kosovare. Ajo shtoi se nuk ka hapësirë të mjaftueshme lidhur me informimin e opinionit të gjerë për aktivitetet e Qeverisë në rrugën e integrimi evropiane dhe për punën që janë duke e bërë Qeveria dhe Komisioni për Integrimi drejt integrimi.

**Naser Rugova** - Tha se Komisioni për Integrimi Evropiane do të ketë rol kyç në procesin e harmonizimit dhe të integritit. Lidhur me dobësitë që i paraqiti zv/kryeministri, theksoi se janë dobësi që kanë ekzistuar që nga koha e transicionit, sidomos nga fillimi i procesit të stabilizim asociimit. Propozoi të ketë angazhim më të madh dhe çështje parësore të jetë sfera e sundimit të rendit dhe të ligjit, sepse deri më tani nga të gjitha anketat, vlerësimet dhe studimet që janë bërë për këtë çështje, del se nuk ka funksionim të rendit dhe të ligjit në Kosovë. Shtoi se kujdes i posaçëm duhet t'u kushtohet reformimit të gjyqësorit dhe administratës. Sa u përket objektivit të dytë politik, të drejtave të njeriut dhe integritit të minoriteteve në Kosovë, theksoi se shoqëria e Kosovës e ka dhënë provimin. Lidhur me objektivat e ekonomisë tha se një raport i publikuar nga mekanizmat relevantë, ku ishte i pranishëm edhe kryeministri, del se 35% mbizotëron ekonomia informale dhe buxheti i Kosovës në këtë mënyrë dëmtohet. Për këtë propozoi të shikohen përvojat e vendeve të rajonit, që të tejkalohet kjo fazë, sidomos përvoja e Kroacisë. Lidhur me përkthimin e **aquis communitaire**, tha se deri më tani nuk është përkthyer as edhe një faqe nga 60 deri në 80 mijë sosh që duhet të përkthehen. Ceku se kemi intencë të bashkohen Komisioni për Integrimi Evropiane i Maqedonisë, i Shqipërisë dhe i Kosovës për ta bërë një shtytje ndërparlamentare. Ai shtoi se kemi probleme me funksionimin e Kushtetutës në tërë territorin e Kosovës dhe me mosfunksionimit e pikave kufitare. Kërkoj të ushtrohet ndikim edhe te kryetari i Kuvendit që ta mbështesë Komisionin për Integrimi Evropiane, në mënyrë që ky Komision të mund të bëjë diplomaci parlamentare. Propozoi që buxheti i Kuvendit të Kosovës të shikohet në bazë të prioriteteve. Lobimin e konsideroi si prioritet.

**Njomza Emini** - Tha se nga përvojat e vendeve të rajonit të gjithë e dimë sa kohë duhet të kalojë deri sa të nënshkruhet Marrëveshja e stabilizim asociimit. Për këtë pyeti sa ka bërë Qeveria për përshpejtimin e nënshkrimit të Marrëveshjes së stabilizim asociimit.

**Hydajet Hyseni** - Theksoi se janë angazhuar njerëz përkatës në vende përkatëse. Shtoi se nevojat e Kosovës janë më të mëdha sesa të arriturat, por edhe mundësitë janë më të mëdha. Kërkoj të ketë bashkërendim më të madh në mënyrë që të mos ketë mosvazhdimësi dhe mungesë informatash. Propozoi të jetë një trup që do ta bënte harmonizimin e angazhimeve për këto çështje. Për këtë më kompetentja është Qeveria. Lidhur me integrimet, gjatë vizitave që i kemi pasur në vendet fqinje, kemi parë se në vende të tjera janë angazhuar një armatë aktivistësh. Kjo s'mund të mos jepte rezultate të duhura. Nuk duhet përjashtuar mundësia për angazhim edhe të Komisionit për Integrimi Evropiane, sepse MPJ-a është e angazhuar për integrimin e Kosovës në struktura evropiane dhe në struktura të tjera ndërkombëtare. Më ka bërë përshtypje lobimi për

Kosovën dhe pyeti çka u bë me lobet tona që i kemi pasur nëpër botë. Tha se nuk konsultohen fare, prandaj mërgata është demoralizuar. Po ashtu revista "Ura" është ndërprerë e nuk dihet pse. Propozoi të shfrytëzohen linjat e bashkëpunimit rajonal që kanë ekzistuar dhe të aktivizohen projektet që kanë pasur efekte pozitive. Lidhur me harmonizimin e ligjeve tha se jemi fokusuar për harmonizimin e tyre, por këtë e bëjmë vetëm në mënyrë sipërfaqësore dhe pa ndonjë ekspertizë konkrete. Kërkoj forcimin e ekspertizës dhe mbështetje profesionale për këtë sektor.

**Edita Tahiri** - Shtoi se qëndrojnë të gjitha ato që u thanë. Ajo tha se është shqetësuese se disa vende anëtare të BE-së nuk e kanë njohur Kosovën. Kjo është pengesë kryesore për nënshkrimin e Marrëveshjes, derisa edhe Serbia që ka pasur rol destruktiv, gjatë gjithë këtyre viteve, e ka nënshkruar këtë marrëveshje. Ajo e rikujtoi porosinë e ambasadorit Hollbruk, të insistohet që integrimi i Serbisë të kushtëzohet me njohjen e Kosovës, në mënyrë që Ballkani Perëndimor të ketë qasje të njëjtë në procesin e integrimi, veçmas Kosova që ishte faktor stabilizimi. Propozoi që së bashku Qeveria, Komisioni dhe zv/kryeministri të kenë bashkërendim në planin e diplomacisë parlamentare dhe të marrin pjesë në seancat e rregullta vjetore të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të Evropës, në mënyrë që të ketë shkëmbim përvojash për ngritjen e standardeve dhe kështu të llojnë për Pavarësinë e Kosovës. Ajo shtoi se duhet të avancohen standardet dhe kriteret në dy kahe, siç janë korrupsioni dhe sundimi i ligjit. Kjo qeveri ka ardhur në pushtet me një platformë kundër korrupsionit, por ajo duhet edhe të fillojë t'i zbatojë këto synime. Lidhur me luftimin e korrupsionit propozoi të shfrytëzohen të dhënat që i ka nxjerrë Auditori i Përgjithshëm për qeveritë e kaluara dhe nga to të marrin mësim kjo qeveri dhe qeveritë e ardhshme. Sa i përket sundimit të ligjit tha pres të ketë veprime më të fuqishme në drejtim të ngritjes së cilësisë së punës së organeve të drejtësisë dhe të ngrihen standardet, sepse edhe dera për në BE hapet më mirë kur ne në vend i rrisim standardet.

**Branislav Grbiq** - Theksoi se integrimi i Kosovës në mekanizmat ndërkombëtarë është një proces i ndërlikuar, jo vetëm në kërkim të pjesëmarrjes në to, por problemi është që Evropa ta njohë Kosovën si një shoqëri qytetare dhe ne si qytetarë të saj të jemi të vendosur për atë që kërkojmë. Shtoi se Kosova është shoqëri multietnike, prandaj duhet të ekzistojë një përgjegjësi më e madhe për jetesë të përbashkët. Duhet t'i bëjmë njerëzit më të përgatitur dhe të jenë përgjegjës për kërkesat e tyre. Vetëm me mundësi ligjore mund ta formojmë një proces që do të shkonte më shpejt. Kemi parë në Shqipëri dhe në Kroaci se ky proces është shumë i ndërlikuar, për të cilin duhet të miratohen shumë ligje që janë shumë të ndërlikuara. Kërkohet të jemi shoqëri e organizuar që mund t'u përgjigjet proceseve të ndërlikuara. Vetëm në këtë mënyrë mund të hyjmë si shoqëri konkurrenente në Evropë.

**Fatmir Rexhepi** - Tha se për secilin deputet dhe qeveritar nuk ka objektiv më të rëndësishëm se rruga për integrimi evropiane. Kërkoj opinionin e zv/kryeministrit se nga 15 qershori, me hyrjen në fuqi të Kushtetutës dhe me ndryshimin e kompetencave pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës, sa dhe si po manifestohen pengesat që po i paraqiten funksionimit të Qeverisë në fushat që u përmendën më lart, si dhe a kanë ndikuar këto ndryshime për njohjen e shtetit të ri?

**Hajredin Kuçi** - Sa i përket koordinatorit për IPA-në tha se koordinatorë është caktuar Mimoza Gojani. Lidhur me qendrën e përkthimit të **aqius communautaire** kemi arritur një draftmemorandum me Shqipërinë, por po e presim sinjalin edhe nga Maqedonia. Premtoi se do të angazhohet të ketë hapësirë më të madhe sa i përket informimit të opinionit lidhur me punën e Qeverisë për integritet evropian. Lidhur me sundimin e rendit dhe të ligjit presim ngritjen e kapaciteteve pas nënshkrimit të Memorandumit të bashkëpunimit nga Komisioni Evropian, nga USAID-i dhe nga kryetari i Gjykatës Supreme për riemërimin e prokurorëve dhe të gjyqtarëve. Shtoi se e kemi ruajtur strukturën e Kosovës pas pavarësimit dhe ka tre vjet që nuk ka asnjë incident ndëretnik. Sa u përket objektivave të ekonomisë e presim edhe ndihmën tuaj për hartimin e ligjeve të caktuara. Propozoi të ketë bashkërendim më të madh dhe çdo dikaster t'i përgjigjet Kuvendit, sepse përballë botës do ta kemi vetëm një proces dhe duhet të jetë vetëm një përfaqësim. Shtoi se duhet të rritet niveli i bashkëpunimit me mërgatën dhe me rajonin. Deri më tani kemi bashkëpunim shumë të mirë me Shqipërinë dhe me Slloveninë. Duhet të insistohet që integritet i Serbisë të kushtëzohet me njohjen e Kosovës. Njoftoi se më 9 tetor, në Kosovë, do të vijë Oli Ren për nënshkrimin e një marrëveshjeje me kryeministrin për bashkëpunim në fushën e IPA-së. Sa i përket pjesëmarrjes në seancat e Parlamentit Evropian dhe në Këshillin e Evropës, Qeveria do të subvencionojë një delegacion të përbërë edhe nga deputetët. Sa u përket kufizimeve buxhetore për Komisionin për Integritet Evropian, propozoi të kërkohet të rritet shuma e buxhetit për procesin e integriteteve. Tha se sundimi i ligjit nuk duhet të përfundojë me një deklaratë, por duhet të përfundojë me zbatimin e ligjit në mënyrë që të përgatitet vendi si shoqëri konkurrense. Si pengesë po na paraqitet mosshtrirja e autoritetit të Kushtetutës në tërë shtetin. Nëse Kosova s' do të aspironte të anëtarësohej në organizmat ndërkombëtarë, do të kënaqej me këto njohje, por pasi kemi aspirata të anëtarësohemi në to, duhet të punojmë sa më shumë për njohje. Për fund tha se nga kjo mbledhje ka marrë ide të reja dhe është i gatshëm të raportojë para Komisionit sa herë të kërkohet.

**Edita Tahiri** - Kërkoj nga zv/kryeministri ta japë mendimin e tij rreth çështjes së korrupsionit.

**Hajredin Kuçi** – Tha mendoi se korrupsioni ka rëndësi të luftohet në tri fusha: në administratë, në politikë dhe në ekonomi. Shtoi se në Kosovë fatkeqësisht luftohet vetëm korrupsioni në administratë. Korrupsioni duhet të luftohet nga shtëpia. Ne jemi të gatshëm ta luftojmë korrupsionin. Kundër çdokujt që bën veprim korruptiv do të merren masa. I ftoi të gjithë që për çdo rast të shkojnë në organet e hetuesisë, sepse korrupsioni hyn në një shoqëri, por s' mund të dalë pa bashkëpunim prej saj. Ne tha jemi të gatshëm të marrim masa ndaj çdonjërit kur hetohet se ka korrupsion.

Kryesuesja e *falënderoi* zv/kryeministrin për gatishmërinë për të bashkëpunuar me Komisionin për Integritet.

#### **4. Të ndryshme**

##### **a) Rreth propozimit të Komisionit për Punë të Jashtme**

**Kryesuesja** – I njoftoi anëtarët e Komisionit se Komisioni për Punë të Jashtme ka propozuar që të gjitha komisionet të parashtrajnë kërkesë edhe te Komisioni për Punë të Jashtme për shqyrtimin e udhëtimeve. Ajo shtoi se kjo është edhe një vështirësi për realizimin e demokracisë parlamentare.

*Naser Rugova, Edita Tahiri dhe Fatmir Rexhepi, pas diskutimeve të deputetëve, propozuan të shqyrtohen edhe procedurat e vendeve të tjera për rregullimin e kësaj çështjeje.*

**Kryesuesja** konstatoi se Komisioni e nxori këtë

##### ***Përfundim***

*Të verifikohet propozimi i Komisionit për Punë të Jashtme, të reagohet ndaj propozimit dhe të jepet propozimi për krijimin e një mekanizmi për bashkërendimin e diplomacisë parlamentare.*

Mbledhja përfundoi në orën 12:20 min.

**Përgatiti**

**Njësia për mbështetjen e Komisionit**

**Kryesuesi i Komisionit**

**Zylfije Hundozi**